

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	3
Konteksti i këtij vlerësimi	4
Raporti përmbledhës	5
Përmbledhje e gjetjeve	6
Përmbledhje e Vlerësimeve për çdo Fushë Vlerësimi	7
Përmbledhje e Vlerësimit	7
Raport i detajuar	8
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	8
Fusha e vlerësimit 2: Burimet	13
Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula	19
Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	24
Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre	29
Lista e evidencave	32
Lista A: Lista e evidencave	32
List B: Meetings held during the visit:.....	38
Lista C: Lista e evidencave të paraqitura gjatë vizitës në ambient.	38

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle i përmbushin institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi ekspertësh të vlerësimit të jashtëm, që përbëhet nga ekspertë të kombinuar ndërkombëtarë dhe shqiptarë të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet te shkalla e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'u ofruar informacion IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve për mënyrën se si i përmbushin IAL-të standardet. Ky raport i ndihmon dhe IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli i përmbush IAL-ja standardet. Format e gjykimit që mund të japin ekspertët janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti "Aldent" (UAL) është një nga institucionet e para të arsimit të lartë jopublik në Shqipëri. Institucioni është zhvilluar dhe konsoliduar me një përvojë më të gjatë se 18 vjet, duke u bërë faktor i rëndësishëm për edukimin e brezave në Shqipëri. Filozofia e institucionit është ofrimi i standardeve më të mira të mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera akademike dhe shkencore. Në funksion të kësaj filozofie, institucioni ka matur dhe vlerësuar cilësinë e tij duke kryer disa procese akreditimi/riakreditimi institucional dhe programesh studimi që e kanë ndihmuar institucionin të përmirësohet vazhdimisht. Në të njëjtin drejtim ecën edhe ky proces riakreditimi që ndodh pas përfundimit të procesit të akreditimit në vitin 2017.

Universiteti "Aldent" (UAL) është një nga institucionet e para të arsimit të lartë jopublik në Shqipëri. UAL-ja është licensuar si institucion i arsimit të lartë jopublik në vitin 2006, me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 673, datë 27.09.2006 dhe është riorganizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 539, datë 13.06.2013 (ndryshimi i statusit nga "Shkollë e Mesme Universitare" në "Universitet") dhe urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit (UMAS) Nr. 115, datë 13.03.2017 (hapja e një njësie të re kryesore dhe riorganizim institucional). UAL-ja është akredituar/riakredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH) Nr. 240, datë 26.05.2011 (si Fakulteti i Shkencave Mjekësore), Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit (UMAS) Nr. 111, datë 11.03.2016 dhe Vendim të Bordit të Akreditimit (VBA) Nr. 114, datë 15.12.2017.

Filozofia e institucionit është ofrimi i standardeve më të mira të mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera akademike dhe shkencore. Në funksion të kësaj filozofie, institucioni ka matur dhe vlerësuar cilësinë e tij duke kryer disa procese akreditimi/riakreditimi institucional dhe programesh studimi që e kanë ndihmuar institucionin të përmirësohet vazhdimisht.

Universiteti ka tri fakultete, Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Fakultetin e Shkencave Stomatologjike dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, të vendosura në 4 godina kryesore, 2 prej të cilave janë pjesë e kampusit të ri. UAL-ja ofron 13 programe studimi të ciklit të parë të dytë dhe të tretë si dhe programe profesionale, përkatësisht: 1 program profesional, 5 programe të ciklit të parë, 6 programe të ciklit të dytë dhe 1 program të ciklit të tretë. Ka 100 persona si staf akademik me kohë të plotë dhe 82 persona të tjerë që përfshihen me kohë të pjesshme. UAL-ja ka dhe 13 staf administrativ dhe 21 ndihmës. Numri aktual i studentëve të UAL-së është rreth 2150 studentë në të tri ciklet e studimit.

UAL-ja e ka ndjekur objektivin kryesor të strategjisë së saj të zhvillimit që është ndërtimi i një kampusi të ri universitar, duke përmbushur kërkesat maksimale të një IAL-je. UAL-ja vijon të ruajë orientimin dhe funksionin e vet vetëm me programe në fushën e mjekësisë. Numri i studentëve në UAL rritet nga viti në vit. Shkëmbimet mes studentëve dhe stafit rrite, si pasojë e përfshirjes së UAL-së në projekte të ndryshme të Komitetit Evropian, të tilla si Erasmus, etj., dhe brenda kuadrit të bashkëpunimit bilateral.

Raporti përmbledhës

UAL-ja ka aplikuar në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), më datë 18.10.2021, me shkresën Prot. nr. 58 për fillimin e procesit të riakreditimit institucional dhe pas konfirmimit nga ASCAL-i, Senati Akademik, me vendimin nr. 05, datë 31.03.2022 (Ev. Nr.36.0), ngriti Grupin e Vetëvlerësimit (Ekipi i Vetëvlerësimit - GVB) i cili, sipas detyrimit ligjor, përbëhet nga stafi akademik dhe përfaqësues nga Këshilli Studentor.

Për hartimin e raportit, GVB-ja është konsultuar për një gamë të gjerë informacionesh dhe dokumentesh, ka zhvilluar takime dhe diskutime me anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe mbështetës të UAL-së dhe raporti është rezultat i kontributit të dhënë nga i gjithë stafi akademik dhe joakademik i UAL-së, njësitë administrative dhe mbështetëse dhe studentët.

Vizita vlerësuese u krye gjatë dy ditëve, në datat 7 dhe 8 qershor 2022. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë me përvojë në arsimin e lartë nga Shqipëria dhe Kosova. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një person që mbante shënime, i vënë në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe dokumente mbështetëse, tetë javë para fillimit të vizitës së vlerësimit. Grupi nuk kërkoi dokumentacion shtesë. Leximi i dokumentacionit të ofruar i dha mundësinë grupit të njihje me strukturën, politikat dhe procedurat menaxhuese, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Dokumentet e shqyrtuara nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përfshinin Statutin e universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, listën e projekteve kërkimore, shembujt e informacionit të programit, si dhe dokumentacionin e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë kësaj vizite, u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan grupit të kuptuarin më qartë të përgjegjësive, procedurave dhe pikëpamjeve të stafit dhe të studentëve. Grupi mundi të takohej me Rektoren, menaxherët e lartë, studentët e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, stafin akademik, administrativ dhe ndihmës, si dhe me partnerë të jashtëm, ish-studentë dhe punëdhënës. Grupi pati dhe takime specifike me dekanët dhe shefat e departamenteve, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Grupin e Vetë-Vlerësimit. Në të gjitha takimet u mbajtën shënime si dokumentacion dhe burim referimi i rezervuar vetëm për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Si pjesë të turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, hapësirat e mësimdhënies, laboratorët, dhe zyrat. Pas vlerësimit të të gjitha evidencave të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e renditura në vijim.

Dy rekomandimet për vendimin e mëparshëm të Bordit të Akreditimit janë përmbushur .

Për fushën e vlerësimit 1: Organizata dhe Menaxhuesit e saj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar praktike të mirë, dobësi, rekomandime apo pohime dhe arriti në përfundimin se standardet e kësaj fushe janë përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 2: Burimet, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy tipare praktike të mirë në lidhje me shërbimet e ofruara nga Universiteti për kategori të ndryshme personash, si dhe aktivitete humanitare dhe mjedise të shkëlqyera për

mësimdhënie dhe mësimnxënie, zhvillimin e infrastrukturës dhe burime të përshtatshme mësimdhënieje dhe mësimnxënieje për të mbështetur programet e diplomës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar praktike të mirë, dobësi, rekomandime apo pohime dhe arriti në përfundimin se standardet e kësaj fushe janë përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 3: Kurrikulën, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një tipar praktike të mirë në lidhje me programet profesionale që ofrohen nga Universiteti "Aldent", në përputhje me kërkesat e tregut dhe politikat dhe strategjitë e zhvillimit të shëndetësisë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe një rekomandim në lidhje me inkurajimin e UAL-së për të pasur programe mësimore në gjuhën angleze si avantazh që kontribuon për ndërkombëtarizimin e universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar praktike të mirë, dobësi, rekomandime apo pohime dhe arriti në përfundimin se standardet e kësaj fushe janë përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një rekomandim lidhur me nxitjen e UAL-së për të pasur më shumë aktivitete kërkimore të lidhura dhe në përputhje me arritjet e reja shkencore dhe trendet mjekësore botërore, për shkak të pengesave gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar praktike të mirë, dobësi, apo pohim dhe arriti në përfundimin se standardet e kësaj fushe janë përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një rekomandim lidhur me inkurajimin e UAL-së për ta rritur vazhdimisht bibliotekën dhe titujt e librave elektronikë, dhe abonimet e bibliotekës elektronike edhe për përdorim të përgjithshëm të institucionit, si një ndihmesë e rëndësishme për studentët dhe stafin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar praktike të mirë, dobësi, rekomandime apo pohime dhe arriti në përfundimin se standardet e kësaj fushe janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Shërbimet e ofruara nga UAL-ja për kategori të ndryshme personash si dhe aktivitete humanitare **[Kapitulli III Standardi VII.6]** ;
- Ambiente të shkëlqyera mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, zhvillim të infrastrukturës dhe burimet e duhura për mësimdhënie dhe mësimnxënie për të mbështetur programet e diplomës **[Kapitulli III Standardi V.1]**
- Universiteti "Aldent" ofron programe profesionale në përputhje me kërkesat e tregut dhe politikat dhe strategjitë e zhvillimit të shëndetësisë kombëtare dhe ndërkombëtare **[Kapitulli I Standardi I.4]**

Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UAL-ja nxitet që të ketë programe mësimore në gjuhën angleze, si avantazh që kontribuon për ndërkombëtarizimin e universitetit **[Kapitulli I Standardi 1.10];**
- UAL-ja nxitet që të zhvillojë më shumë aktivitete kërkimore të lidhura dhe në përputhje me arritjet e reja shkencore dhe trendet mjekësore botërore, për shkak të pengesave gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. **[Kapitulli II Standardi 1.8];**
- UAL-ja nxitet që t'i shtojë vazhdimisht bibliotekën dhe titujt e librave elektronike, dhe abonimet e bibliotekës elektronike edhe për përdorim të përgjithshëm të institucionit, si një ndihmesë e rëndësishme për studentët dhe stafin. **[Kapitulli I Standardi III.5].**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Përmbledhje e Vlerësimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet **janë përmbushur plotësisht.**
3. Standardet për Kurrikulën **janë përmbushur plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin **janë përmbushur plotësisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre **janë përmbushur plotësisht.**

Përmbledhje e Vlerësimit

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin "Aldent", Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përmbushur plotësisht.**

<https://ual.edu.al/ual.edu.al/journal-ajbs/> ;<https://aldentconference.org/>) **[Kapitulli III Standardi I.2].**

- 1.3 Siç përcaktohet në Statut (**Ev. 01.1**), të gjitha autoritetet e Universitetit dhe njësitë akademike dhe administrative kanë role dhe përgjegjësi të përcaktuara sipas fushës së autoritetit dhe ekspertizës së tyre. Takimet zhvillohen periodikisht sipas agjendave të përgatitura dhe të shpallura paraprakisht (**Ev. 04.0; 0.4.1**). Të gjithë anëtarët e Senatit Akademik mund të hapin tema diskutimi. UAL-ja e inkurajon debatin konstruktiv të të gjitha organet kolegjiale, komisionet e përhershme, njësitë bazë, senati akademik (**Ev. 05.1**). Edhe në takimet online të asamblesë së stafit akademik zhvillohen dhe inkurajohen debate konstruktive dhe shkëmbim përvojash (**Ev. 09.1**). Vendimet e senatit akademik nënshkruhen nga drejtuesi i Senatit Akademik dhe publikohen sikurse përcaktohet në rregulloren e brendshme (**Statuti i UAL-së, neni 16**) dhe kjo u konfirmua në takime me stafin e Universitetit (**M6**) **[Kapitulli III Standardi I.3].**
- 1.4 Organet kryesore kolegjiale në Universitet janë renditur më sipër (**Paragrafi 1.2**). UAL-ja ka miratuar mekanizma për kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarisë së vet, ka zbatuar rregulla dhe rregullore që i mundësojnë Universitetit të respektojë kufijtë e autonomisë së tij (**RVV, f. 10, M10, M6**). Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) në përputhje me kuadrin ligjor, që vlerëson cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarisë mësimore, si dhe të gjitha temat lidhur me studentët dhe stafin akademik dhe administrativ (**Ev. 7.0; 7.1**). Universiteti ka bashkëpunuar dhe me ekspertë dhe përfaqësues të jashtëm si pjesë e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe administrativ. Anketimin e studentëve dhe stafit e ka kryer Instituti për Cilësi në Arsim (Ev. (**Ev. 22**)). Kontrolli vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit finalizohet nga një raport që UAL-ja e përdor si udhëzues të rëndësishëm, veçanërisht për vitin akademik pasues (**Ev. 29.1**). Universiteti është organizuar në një mënyrë që i ka mundësuar përfitimin nga financimet nga programet e BE-së, për shembull Horizon 2020 dhe Erasmus + (**Ev. 41.1| 41.2; 41.2.1**) **[Kapitulli III, Standardi I.4.]**
- 1.5 Strategjia e parë e Zhvillimit të Universitetit, hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, u krijua për periudhën 2015-2020 dhe ishte bazë e fortë për hartimin e strategjisë së re 2021-2025 (**Ev. 02.0**). Arritja kryesore e strategjisë së mëparshme ishte realizimi i kampusit të ri universitar (**Tur**). Strategjia e re u diskutua me hollësi nga universiteti, duke nisur që nga njësitë bazë deri te Senati Akademik dhe studentët (**Ev. 2.1.1**). Strategjia është një dokument shumë i qartë, i detajuar dhe gjithëpërfshirës që mbulon sfidat, misionin, vizionin, objektivat, menaxhimin, burimet njerëzore dhe fizike, sigurimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve mësimore për studentët dhe stafin, rritjen e kapaciteteve laboratorike, bashkëpunimin me institucionet arsimore homologe, bashkëpunimin me sektorin publik ose privat, duke krijuar kushte më të mira për mësimnxënien dhe argëtimin (**Ev. 2.0**) **(Kapitulli III, Standardi I.5)**
- 1.6 Sipas ligjit, UAL-ja dorëzon një raport vjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Ky raport mbulon aktivitetet kryesore të atij viti të Universitetit duke përfshirë arritjet dhe të dhënat mbështetëse në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, progresit

ekonomik, bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, etj. **(Ev. 03.1)**. Raporti Vjetor hartohet nga Rektorati, bazuar te raportet vjetore të njësive kryesore. Raporti diskutohet dhe miratohet nëpërmjet strukturave të brendshme të universitetit **(RVV, fq.11)** dhe shpërndahet nëpërmjet faqes së universitetit në internet për studentët dhe stafin **[Kapitulli III Standardi I.6]**.

- 1.7 Universiteti ka krijuar strukturat e duhura për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij. Strukturat organizative dhe drejtuese janë ngritur sipas Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit **(Ev. 1.2)** dhe Universiteti funksionon në përputhje me to dhe me ligjin përkatës në Shqipëri. Gjithashtu, në përputhje me Statutin, Universiteti i siguron autonomi të plotë Senatit Akademik **(M12)** dhe liri akademike stafit të vet akademik **(M6)**. Stafi akademik është i lirë të përcaktojë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies; kërkimin shkencor, në përputhje me strategjinë e universitetit; si dhe të ndryshojë programet, të përmirësojë dhe përditësojë kurset, të përcaktojë kriteret për punësimin e stafit të jashtëm akademik, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, etj. **(Ev. 03.0)**, **(M6)**. UAL-ja ka tri fakultete: Fakultetin e Shkencave Mjekësore; Fakultetin e Shkencave Stomatologjike; Fakultetin e Shkencave Teknike Mjekësore. Çdo fakultet ka 3 njësi bazë përkatëse që kanë secila të paktën 7 pedagogë me kohë të plotë, prej të cilëve, të paktën 3 kanë diploma dhe tituj. UAL-ja ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë (program specializimi afatgjatë) si dhe programin e studimit profesional **(RVV, f 12)**, një numër total prej 13 **(Ev. 03.0)**, të cilat janë të akredituara, në proces akreditimi ose riakreditimi, ose brenda afateve ligjore për akreditimin. Të gjitha njësitë në Universitet janë autonome brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe Universiteti ka organizuar strukturat e mëposhtme administrative: Zyrën e sekretarisë mësimore, Zyrën e Karrierës, Zyrën e Financës, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Zyrën e TI-së, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Njësinë e Shërbimeve Mbështetëse, etj **(RVV, f. 13)**. UAL-ja ka faqen zyrtare **www.ual.edu.al** në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht, si dhe faqet zyrtare në rrjetet më të frekuentuara sociale, si facebook dhe instagram. UAL-ja ka dhe faqen zyrtare të revistës shkencore AJBS (<https://www.ajbsonline.com/>), platformën e zhvillimit të konferencës ICMS (<https://aldentconference.org/>) dhe platformën e menaxhimit UAL - LMS (<https://ual.ige.al>) **[Kapitulli III Standardi II.1]**.
- 1.8 Struktura e Universitetit e përshkruar më sipër dhe e paraqitur në grafikun organizativ **(Ev. 01.2)** nuk e përfshin këshillin e institucionit. UAL-ja mundëson marrjen e vendimeve në mbledhjet e njësive bazë si dhe në mbledhjet e asambleve të stafit akademik, të cilat transmetohen sipas hierarkisë. **(Ev. 04.1)**. Para se të merret një vendim përfundimtar në Senat, bëhen konsulta dhe diskutime të plota **(RVV, p. 13; M9)**. Studentët kanë qeverinë e tyre që funksionon në mënyrë të pavarur nga institucioni dhe është organi ku studentët shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për mbarëvajtjen e punës së institucionit në shërbim të mësimdhënies dhe edukimit **(Ev. 17.1; 17.2)** **[Kapitulli III Standardi II.3]**.
- 1.9 UAL-ja kryen studime tregu për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të vet. Institucioni shqyrton nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Për shembull, pandemia e Covid 19-ës, pavarësisht shumë ndikimeve negative **(Ev. 41.2.1)**, patinjë anë "pozitive" pasi kërkesat për të punësuar ish-studentët e tyre u shtuan, veçanërisht në fusha, si infermiera, farmacia, laboratorët mjekësorë etj. UAL-ja i ndihmon studentët

e vet që duan të punësohen jashtë vendit, pasi disa nga fushat e ofruara nga institucioni janë shumë të kërkuara. Universiteti ka një bashkëpunim të mirë me konkurrentët privatë dhe publikë në treg, organizon konferenca të përbashkëta me institucionet partnere, zhvillon aktivitete të ndryshmedhe, në raste të tilla, qeveria studentore luan rol të rëndësishëm (Ev. 17.3; 42.2). UAL-ja përpiqet që të ruajë kontaktet me gjithë të diplomuarit e vet, duke përdorur mënyra të ndryshme, si telefonin, e-mail-in, postën dhe median sociale (M9; M12) [Kapitulli III Standardi III.1].

- 1.10 UAL-ja i është përkushtuar bashkëpunimit dhe partneritetit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, siç shkruhet në Strategji, veçanërisht me Universitetin e Mjekësisë së Tiranës. Institucioni merr parasysh kërkesat e vendit dhe të tregut të punës për specialistët e fushës së mjekësisë, për hapjen e programeve të reja, siç është rasti i programit të studimit profesional “Asistent Stomatolog” i hapur në vitin akademik 2021-2022, apo hapja e programit të studimit Bachelor për “Teknik Imazherie dhe Radioterapie” (Ev. 11.0). Universiteti mirëpret dhe studentë nga Kosova, Maqedonia e Veriut apo Mali i Zi në disa profile, si Kirurgji Orale dhe Ortodonti. (RVV, p.15; M. 3, M. 4, M. 5) [Kapitulli III Standardi III.2].
- 1.11 Universiteti ka një listë mbresëlënëse marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe private, institucione spitalore, klinika dentare, imazheri, farmaci, bashkëpunim me kompani ndërkombëtare etj. (Ev. 41.0; 41.1; M11). Këto marrëveshje e kanë lehtësuar trajnimin praktik të studentëve, por edhe trajnimin e stafit dhe studentëve për metodat e reja të trajtimit të dhëmbëve apo përdorimin e pajisjeve bashkëkohore. UAL-ja bashkëpunon dhe me shoqatat dhe urdhrat e profesionistëve të shëndetit, si Urdhri i Infermierit, Urdhri i Stomatologut, Urdhri i Farmacistit, si dhe me shoqata të ndryshme, si Shoqata Shqiptare e Fizioterapisë, Shoqata e Stomatologëve, Shoqata e Kirurgjisë Maksilofaciale, etj. [Kapitulli III Standardi III.3].
- 1.12 Universiteti i ka promovuar në mënyrë aktive shkëmbimet e stafit dhe studentëve nëpërmjet Erasmus +, CEEPUS, dhe bashkëpunimit dypalësh me mbështetje financiare nga UAL-ja, megjithëse pandemia Covid-19 i ka pezulluar përkohësisht shumë projekte (Ev. 41.1). Universiteti ka nënshkruar shumë marrëveshje me Universitete të ndryshme të huaja. Profesorë dhe mjekë të huaj po e zhvillojnë mësimdhënien teorike nëpërmjet leksioneve dhe sesioneve praktike në programin afatgjatë të Specializimit në Stomatologji. UAL-ja ndjek politika favorizuese për promovimin dhe kualifikimin e stafit nëpërmjet sponsorizimit të pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet botimeve të ndryshme në revista me influencë (Ev. 42.0; 42.1; 42.3; M6) [Kapitulli III Standardi III.4].

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë.

Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Vendimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht.**

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UAL-ja e publikon grafikun e saj organizativ (**Ev. 01.2**) në faqen e internetit të Universitetit dhe në Statut(**Ev. 01.1**). Procesi i rekrutimit dhe punësimit për personelin me kohë të plotë dhe të pjesshme bëhet sipas politikave dhe procedurave të mirëpërcaktuara (**RVV, f. 18; Ev. 18.0, 18.1, 18.4, 18.5, 18.6**), për të cilat Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është informuar edhe në takimet me stafin mësimdhënës dhe Rektoratin (**M.6; M9**). Kriteret për çdo vend të lirë pune propozohen nga departamenti përkatës dhe në fund Rektorati ndjek procedurat për shpalljen e vendeve të lira të punës (**Ev. 18.1.1**). Institucioni i publikon kriteret e punësimit për çdo vend të lirë pune në faqen zyrtare, në llogaritë zyrtare në rrjetet UAL, pranë zyrës së informacionit të institucionit, në faqet online që shpallin vendet e lira të punës, dhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta, sipas interesit, për të rekrutuar personalitete të njohura të fushave përkatëse etj. UAL-ja ndjek dhe politika për promovimin e stafit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme, siç u përmend më lart, për kualifikime të mëtejshme profesionale, botime dhe kërkime shkencore. UAL-ja e mbështet financiarisht stafin që të marrë pjesë në aktivitete shkencore dhe kërkimore brenda dhe jashtë fushës akademike (**Ev. 34.1, 34.5, 42.1, 41.2, 42.3, 43.1**). Procedurat e rekrutimit, përfshirë punësimin dhe kriteret dhe përshkrimin e vlerësimit të punës, përcaktohen nga Statuti dhe rregulloret e brendshme dhe miratohen nga Senati Akademik.(**Ev. 18**). UAL është e gatshme të punësojë staf të kualifikuar që ka marrë diploma dhe tituj shkencorë në universitete të njohura ndërkombëtarisht si në Angli, Itali, Zvicër, Amerikë, Japoni, Republikën Çeke, Francë, etj. (**Ev. No. 42.1, 42.3**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që UAL-ja ndjek politika të hapura lidhur me punësimin dhe rekrutimin e burimeve njerëzore[**Kapitulli III Standardi IV.1**].
- 2.2 Stafi akademik në UAL merr pjesë në aktivitete orientuese dhe informuese, në ditët e promovimit të shëndetit, në aktivitete shkencore, si leksione të hapura, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërimi i studentëve në shkollat verore dhe dimërore, përfshirja në aktivitete kulturore, sportive dhe humanitare, etj. (**Ev.11.1 26.0, 34.1, 34.8, 36.0, 39.0, 42.3, 43.0**). Institucioni ndjek politika të favorshme për integrimin e stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme në aktivitetet e veta shoqërore, nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitete, si ceremonia e hapjes së vitit akademik, ceremonia e diplomimit të studentëve, sporte, etj. (**Ev. 34.7**). Institucioni ndjek politika për përfshirjen e profesorëve të huaj në leksione të hapura (**Ev. 42.2**) [**Kapitulli III Standardi IV.2**].
- 2.3 UAL-ja ndjek politika vlerësimi periodik të performancës së stafit të vet, siç përcaktohet nga Senati Akademik. Institucioni i vlerëson arritjet e stafit të tij bazuar te mësimdhënia (**Ev. 7.3**), puna administrative (**Ev. 07.0; 36.0**) dhe kërkimi shkencor (**Ev. 18.2, 18.3, 42.0, 42.1, 42.3**). Për të vlerësuar performancën e stafit, në mësimdhënie janë përdorur disa burime, përfshirë dhe pyetësorët për studentët (**Ev. 7.3, M3; M4**). Rezultatet e informacionit të mbledhur analizohen nga organet drejtuese të UAL-së (**Ev. 7.3, 7.4**). Stafi mbështetet nga ana financiare dhe logjistike për të marrë pjesë në konferenca, trajnime, kualifikime, aktivitete edukimi të vazhdueshëm dhe seminare, kongrese brenda dhe jashtë vendit në (**Ev. 34.0, 34.1,**

- 34.3, 41.2, 42.1, 42.2, 11.9).** Stafi mbështetet financiarisht për botimet në revista ndërkombëtare me ndikim **(Ev. 34.1) [Kapitulli III Standardi IV.3].**
- 2.4 UAL-ja ofron një gamë aktiviteteve sociale dhe kulturore, sporte etj., si për stafin, ashtu dhe për studentët **(Ev. 17.3, 34.8, 34.7)**. Institucioni promovon dialogun social, siç është hartuar në strategjinë e tij, **(Ev. 2.0; 2.1.1)** nëpërmjet diskutimeve dhe debateve konstruktive, në mbledhje të ndryshme në nivel senati, këshillash, komisionesh etj. **(Ev. 04.1, 05, 5.1, 6.0; M6; M9)**. Universiteti zbaton dhe rregulla të qarta të sigurisë teknike, si marrja e masave mbrojtëse kundër zjarrit dhe trajnimi i herëpashershëm i studentëve dhe stafit; kushtet e studentëve në kompani private, trajnime për ndihmën e parë, trajnimi i studentëve dhe stafit për situata evakuimi emergjent, si tërmet, zjarr, përmytje etj. **(Ev. 33.2, 33.3, 33.4, 33.5) [Kapitulli III Standardi IV.4].**
- 2.5 Institucioni zbaton rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse, të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e Universitetit **(Ev. 1.1)**. Çdo individ informohet nëpërmjet përkrahimit të punës, pjesë e kontratës, për të drejtat, detyrat dhe ndërvarësinë institucionale **(Ev. 18.4, 18.5, 18.6, 18.7) [Kapitulli III Standardi II.2].**
- 2.6 Përpara fillimit të hartimit të buxhetit për vitin e ri fiskal, zyra e rektoratit kërkon që departamentet, fakultetet dhe strukturat mbështetëse dhe administrative të dorëzojnë kërkesat e tyre për burime njerëzore dhe materiale në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit **(Ev. 28.0; 28.1; M9; M12)**. Në kërkesat e tyre, njësitë planifikojnë zëra të ndryshëm financimi që lidhen me kërkimin, si projekte, literaturë, konferenca, botime **(Ev. 12.2, 34.1, 34.3)**, hapjen e programeve të reja **(Ev. 11.1; 11.2)** etj. Si institucion privat, UAL-ja është elastike lidhur me menaxhimin e fondeve, **(Ev. 39.0, 41.2)**. Për hartimin e buxhetit merren parasysh të ardhurat e krijuara nga institucioni nëpërmjet tarifave të shkollimit, shërbimeve, projekteve etj. Shpërndarja e të ardhurave bëhet sipas zërave të buxhetit me përqindjet përkatëse në përputhje me propozimin e Senatit Akademik **(RVV, f. 22) [Kapitulli III Standardi VI.1].**
- 2.7 Pasqyrat financiare vjetore i nënshtrohen auditimit të pavarur, që kryhet sipas kuadrit ligjor. Gjendja financiare i paraqitet edhe Senatit Akademik. Bilanci vjetor i UAL-së është transparent dhe publikohet në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit **(RVV, f. 23)**. Kopjet e buxhetit dhe zbatimi i tij përmbledhen në Raportet Vjetore që publikohen në faqen e internetit të UAL-së. UAL-ja ka zyrën e financës, strukturën e veçantë për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikave financiare, siç thuhet në statutin e Institucionit **(Ev. 1.1)**. Universiteti përgatit çdo vit pasqyrat financiare, kryen raportimin financiar dhe paguan detyrimet tatimore brenda afatit të caktuar **(Ev. 29.1.1)**; ndaj nuk ka detyrime financiare ndaj stafit, studentëve, furnitorëve, bankave, taksave apo palëve të tjera të treta **(Ev. 28.2)**. Prandaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrin në përfundimin se Universiteti ofron mjetet e nevojshme për zbatimin e politikave financiare **[Kapitulli III Standardi VI.2].**
- 2.8 UAL-ja i nënshtrohet auditimit financiar, që kryhet në përputhje me ligjin për këtë qëllim. Kontrollat e vazhdueshme kryhen, si nga vetë institucioni, ashtu edhe nga institucionet tatimore **(Ev. 29.1, 29.1.1)**. Rezultatet e auditimit financiar publikohen në

faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Performanca financiare e UAL-së është rritur me kalimin e viteve **(Ev. 28.3)**. Raporti i aktivitetit financiar i shpallet Senatit Akademik dhe stafit në një mbledhje të hapur. UAL-ja e ka rritur cilësinë e mësimdhënies dhe i ka përmirësuar kushtet infrastrukturore dhe laboratorike duke shfrytëzuar të ardhurat nga tarifat studentore. **(Ev. 7.2; Tur)**. UAL-ja ndjek politika për t'i ndihmuar studentët nëpërmjet lehtësive të ndryshme, si ulja e tarifave për raste të veçanta **(Ev. 34.2.1, 34.4)**; transport falas dhe pjesëmarrje falas në sporte dhe aktivitete të ndryshme sociale. Prandaj, Universiteti ndjek politika kontrolli buxhetor dhe financiar **[Kapitulli III Standardi VI.3]**.

- 2.9 Universiteti ka zhvilluar një sistem të integruar menaxhimi informacioni dedikuar komunikimit, ndërveprimit dhe mësimit dhe trajnimit në distancë, që është në funksion të veprimtarisë akademike dhe administrative të institucionit **(Ev. 31.0)**. Kjo platformë menaxhimi elektronik përmban informacion për modulën e studentëve dhe shërbimin e sekretariatit **(Ev. 31.0)**. Platforma e mësimit elektronik UAL-LMS u modernizua më shumë, veçanërisht pas pandemisë Covid 19, dhe është ende në përdorim **(Ev. 22; 35.0)**. Informacioni është i aksesueshëm dhe për qëllime menaxheriale lidhur me vendimmarrjen dhe botimin në faqen e internetit (<http://www.ual.edu.al/>). Në faqen zyrtare, UAL-ja publikon të dhëna statistikore për numrin e studentëve sipas programeve; ofertat akademike; programet dhe kurrikulat e studimit, kërkesat specifike për çdo program etj.; të dhënat për organigramën e institucionit, strukturën hierarkike; pjesë të statutit dhe rregullores së institucionit. UAL-ja boton Revistën shkencore të titulluar „Albanian Journal of Biomedical Sciences”, AJBS, me ISSN 2521-7321 dhe Bord Redaktorial, krejtësisht në gjuhën angleze (<https://www.ajbsonline.com/>). UAL-ja ka Platformën e Konferencave të Universitetit Aldent (<https://aldentconference.org/>) që i kushtohet administrimit të veprimtarive kërkimore dhe shkencore. Institucioni përdor edhe rrjete sociale, si Facebook dhe Instagram, që administrohen nga zyra e informacionit. UAL-ja përdor bibliotekën online **(RVV. f. 26, Tur, M12) [Kapitulli III Standardi VII.1]**.
- 2.10 UAL-ja është kompjuterizuar. Institucioni ka disa laboratorë të pajisur me rreth 150 kompjutera, disa prej të cilëve shërbejnë si laboratorë kompjuterikë për studentët **(Ev. 33.0; Tur)**. I gjithë stafi i zyrave është i pajisur me kompjutera, printera, fotokopje, skanera dhe të gjitha ndërtesat kanë akses në internet dhe internet wireless **(Tur)**. Të gjitha klasat janë të pajisura me kompjutera dhe video-projektorë dhe/ose tabela smart. Në çdo sallë leksionesh, seminari apo laborator ka dhe një kompjuter të lidhur me internetin ose një mikroskop që shërben për të demonstruar procedurat apo rezultatet e punës laboratorike **(RVV, f. 26; Tur)**. UAL-ja po përdor platformën e arsimimit në distancë (<https://ual.iqe.al/>), në sajë të një kontrate bashkëpunimi me Institutin për Cilësi në Arsim. Gjatë situatës së pandemisë, të gjitha aktivitetet e stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke përfshirë takimet virtuale, uebinarët, prezantimet dhe diskutimet, kryhen nëpërmjet këtij sistemi **(Ev. 21.2, 22.0, 35.0) [Kapitulli III Standardi VII.2]**.
- 2.11 UAL-ja ka ndërtuar një kampus të ri me infrastrukturë moderne për mësimdhënie, kërkime sportive dhe aktivitete sociale **(Ev. 33.0)**. UAL-ja tri qendra si pjesë të strukturës së vet: (i) Qendrën e Shërbimit Klinik dhe Trajnimit; (ii) Qendrën Farmakoterapeutike dhe (iii) Qendrën e Promovimit të Shëndetit. Universiteti ka një

regjistër të pronave të veta të paluajtshme. (Ev. 33.0, 33.1, 33.1.1) dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre të përditshme (Ev. 33.5, 33.4) [Kapitulli III Standardi VII.3].

- 2.12 Universiteti ka politika ruajtjeje dhe zhvillimi të trashëgimisë së pasurisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore (Ev. 01.1; 03). Të gjitha dokumentet ruhen për nevoja dhe përdorim historik në arkivin e institucionit (RVV. f. 28, Tur). UAL-ja ka një bibliotekë ku arkivohet pasuria akademike e institucionit. Libraria është e digjitalizuar plotësisht (Tur; M12) [Kapitulli III Standardi VII.4].
- 2.13 UAL-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për të kryer mësimdhënien, mësimnxënien, kërkimin dhe aktivitete të tjera (Ev. 33.0) dhe administratori planifikon dhe vë në zbatim investime për infrastrukturën (Ev. 33.5). UAL-ja ka një kampus të rime standarte të larta dhe me ambiente që janë dhe ato në përputhje me standardet për ofrimin e hapësirës së duhur për stafin, duke përfshirë vendet e parkimit, zyrat, kafeteritë dhe ambientet e çlodhjes (Ev. 33.0, 34.6, 23.0, 24.0; Tur). Ndërtesa e përdorur ka pamje moderne dhe mjete për të kontrolluar temperaturën (Tur). Është i pajisur me të gjitha ambientet e nevojshme për një mjedis bashkëkohor mësimdhënës dhe mësimnxënës me standarde të larta logjistike, me hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mësimdhënien dhe për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse teorike, praktike dhe laboratorike (Tur) që përmbushin standardet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për numrin e stafit dhe studentëve që i përdorin ato, përfshirë dhe ashensorët për të hyrë në katet e sipërme (Tur) [Kapitulli III Standardi VII.5].
- 2.14 UAL-ja ofron kryesisht shërbime në fushën e shëndetit oral. UAL-ja ofron shërbime pa pagesë në klinikat e veta për kategori të ndryshme pacientësh, si të papunë, pensionistë, fëmijë rruge, gra të dhunuara etj., që kryhen nga studentët (RVV, f. 29, M). UAL-ja ka ofruar trajnime për Covid-in (Ev. 2.0, 24.0, 34.0). UAL-ja, në bashkëpunim me qeverinë studentore, ka kontribuar për nisma humanitare, si mbledhja e fondeve për fshatin SOS, pjesëmarrja në ditët e informimit për kancerin, HIV AIDS, diabetin, dhurimin e gjakut etj. (Ev. 17.2, 17.3). **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrin në përfundimin se shërbimet e ofruara nga UAL-ja për kategori të ndryshme personash si dhe aktivitetet humanitare janë një tipar i praktikës së mirë..** [Kapitulli III Standardi VII.6].
- 2.15 Kampusi i ri i UAL-së ndodhet në një zonë të gjelbër jashtë Tiranës. UAL-ja ka një sipërfaqe të përgjithshme kampusi rreth 8500 m² dhe rreth 2500 m² parkim dhe ambiente ndërveprimi (RVV, f. 29). Universiteti ofron mjedise dhe infrastrukturë me cilësi të lartë dhe të përshtatshme për veprimtari akademike dhe shkencore për stafin dhe studentët e vet dhe për palët e interesuara, duke përfshirë, për shembull, klasa, laboratorë kompjuterikë, laboratorë, biblioteka dhe ambiente çlodhjeje dhe sportive (Tur; Ev. 33.0; 33.5). Ambientet pastrohen dhe mirëmbahen vazhdimisht, dhe një ekip teknikësh i mirëmban të gjitha ambientet duke përfshirë sistemin elektrik, sistemin e ngrohjes dhe të ajrit të kondicionuar. (Tur). Biblioteka ka një sipërfaqe prej 400m², është e pajisur me kompjutera të lidhur me internet të pa kufizuar, me 13500 mijë tituj, dhe e abonuar në "Hinari" (Tur). UAL-ja ka bërë investime të mëdha për laboratorët, si: laboratorët e farmacisë, fizioterapisë, infermierisë, imazherisë, laboratorët dentarë, të stomatologjisë (42 fantazma), të biokimisë klinike,

mikrobiologjisë etj., të kompletuara me pajisje, materiale dhe reagjentë, që përbëjnë një bazë të konsiderueshme për sa u përket programeve dhe projekteve kërkimore studentore (**Ev. 34.6; Tour**). UAL-ja ka edhe 6 salla klinike me 28 njësi, ku studentët, nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve, kryejnë ndërhyrje të ndryshme (**Ev. 24.0; Tur**). Klasat kanë pajisje të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, si videoprojektorë, sisteme zëri, lidhje wireless, tabela smart dhe softuerë të përshtatshëm(**Ev. 69, Tur**). Ndërtesat që përdoren për mësimdhënie dhe mësimnxënie kanë shkallë emergjence(**Tur; Ev. 31.1**) dhe janë të pajisura me sistem mbrojtjeje ndaj zjarrit. UAL-ja ofron kapacitete të mjaftueshme për kualifikimin praktik të studentëve. Studentët i kryejnë praktikat e tyre profesionale në bashkëpunim me institucionet shëndetësore. (**Ev. 41.0, 41.1, M3; M4; M11**), në klinika diagnostikimi, laboratorë dhe farmaci private (**Ev. 14.1, 15.0, 15.1, M3; M4; M11**), në klinika dentare private brenda vendit (**M3; M4; M11**). **Universiteti zotëron ambiente të shkëlqyera mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, (Tur) dhe skuadra e vlerësimit del në përfundimin që zhvillimi i infrastrukturës dhe burimet e duhura për mësimdhënie dhe mësimnxënie për të mbështetur programet e diplomës janë tipar i praktikës së mirë. [Kapitulli III Standardi V.1].**

2.16 UAL-ja ka zyrën e arkivave ku ruhet gjithë dokumentacioni në formë fizike (**Ev. 32**). Institucioni ruan edhe dokumentacionin digjital, si të dhënat bazë të regjistrit të studentëve, ngarkesën mësimore për personelin e brendshëm dhe të jashtëm, që dërgohen rregullisht çdo vit në Ministrinë e Arsimit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), (**Ev. 27.5**) si dhe ngarkohen në sistemin elektronik të ASCAL-it. UAL-ja mban regjistrin bazë dhe regjistrin e diplomimit të studentëve (**Ev. 21.0; 32.2**). Disponohen dhe informacione të përgjithshme për programet e studimit, kurrikulat etj., syllabuset dhe kreditet (**RVV, p. 31**) **[Kapitulli III Standardi V.2].**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Shërbimet e ofruara nga UAL-ja për kategori të ndryshme personash si dhe aktivitete humanitare**[Kapitulli III Standardi VII.6]** ;
- Ambiente të shkëlqyera mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, zhvillim të infrastrukturës dhe burimet e duhura për mësimdhënie dhe mësimnxënie për të mbështetur programet e diplomës **[Kapitulli III Standardi V.1]**

Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Vendimi

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 UAL-ja e promovon aktivitetin akademik dhe programet e studimit që ofron nëpërmjet kanaleve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të komunikimit në faqet zyrtare të internetit dhe llogaritë zyrtare në rrjetet sociale, ku mund të merret informacion i hollësishëm zyrtar për programet në të gjitha ciklet e studimit. UAL-ja e informon publikun nëpërmjet shtypit të shkruar dhe medias vizive, si dhe nëpërmjet fletëpalosjeve dhe katalogut të institucionit **(RVV, p. 32; Ev. 40.0, 44.1)**. Institucioni e organizon fushatën e promovimit dhe informimit të maturantëve në të gjithë vendin edhe nëpërmjet zyrës së Informimit dhe Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me MAS-in.

Organizimi i programeve të studimit bazohet te detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, dhe te rregullorja e UAL-së **(Ev. 03.0)**. Kurset/modulet kanë përcaktuar ngarkesën e krediteve të konvertuara në orë aktive në auditor, që përfshijnë leksione, seminare, orë laborator, detyra/projekte, praktika dhe orë vetëpërgatitjeje studentore. Ngarkesa e krediteve ECTS për një vit akademik është 60 kredite dhe ndjek konvertimin 1 kredit = 25 orë ngarkesë studentore **(RVV, p. 32; Ev. 11.4, 11.5, 11.6)**. Programet e studimit janë të harmonizuara në mënyrë të tillë që organizimi i disiplinave përbërëse të ketë vazhdimësi dhe efikasitet. Kurset e arsimit të përgjithshëm përfundojnë gjatë viteve të para, më pas kurset dhe modulet e integruara dhe mandej kurset profesionale që karakterizojnë programin. Në semestrin e fundit të ciklit të studimeve, kryesisht, parashikohet realizimi i praktikave profesionale të mësimdhënies dhe provimi/ tema e diplomës, që janë në harmoni me lëndët e zhvilluara më parë. Praktikrat klinike dhe laboratorike kryhen gjatë vitit akademik. Për secilën nga programet e studimit ka një rregullore të veçantë **(RVV, f. 33; Ev. 10.1, 10.2, 10.3, 11.4, 11.5, 11.6, 14.0)**.

UAL-ja e organizon të gjithë procesin e pranimit, përzgjedhjen dhe regjistrimin e specialistëve bazuar te parimi i meritokracisë, sipas rregullores së UAL-së, kriteret e miratuara nga Senati Akademik dhe aktet e tjera të rektorit të UAL-së **(Ev. 25.0, 25.1, 25.2)**.

Programet e studimit ndiqen dhe vihen në praktikë nga orë laborator të përshtatshme që bëjnë të mundur ofrimin nga Institucioni të programeve të studimit në përputhje me misionin dhe kapacitetet e tij **[Kapitulli I Standardi I.1]**.

3.2 Programet e ofruara në UAL janë pjesë e profesioneve të rregulluara që kanë nevojë për arsim të vazhdueshëm profesional. Njësitë ndihmëse të institucionit, Qendra Farmakoterapeutike, Qendra për Trajnimin dhe Shërbimin Klinik dhe Qendra për Promovimin e Shëndetit organizojnë vazhdimisht aktivitete edukimi për studentët aktualë, ish-studentët dhe profesionistë të tjerë të interesuar, si dhe aktivitete të ndryshme për rritjen profesionale, akademike dhe kërkimore, si seminare, leksione të hapura, trajnime, konferenca etj., ku aktivizohet stafi i UAL-së dhe lektorë të njohur të huaj, aktivitete që miratohen, monitorohen dhe vlerësohen nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim **(RVV, p. 34; Ev. 01.2, 34.8, 42.2)**. Në këto aktivitete kontribuojnë shpesh edhe institucione të tjera vendase dhe të huaja me të cilat UAL-ja ka marrëveshje bashkëpunimi **(Ev. 38.0, 39.0, 41.0, 41.1) [Kapitulli I Standardi I.2]**

- 3.3 UAL-ja ofron programe studimi në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit të përcaktuar në Statut, ku përcaktohet profili mjekësor, që nga fillimi i aktivitetit, dhe aktualisht UAL-ja ofron programe studimi të akredituar, apo programe studimi, brenda afateve ligjore për akreditimin e tri cikleve në fushat mjekësore. Programet e studimit janë hartuar në përputhje me kompetencat profesionale që do të marrin këta studentë pas përfundimit të diplomimit në UAL (**RVV, p. 35; Ev. 01.1, 11.0, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7**). Projektet strategjike përputhen me ofrimin e programeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Vitet e fundit, UAL-ja e ka rritur kapacitetin e saj njerëzor, logjistik dhe infrastrukturor për të rritur cilësinë akademike (**Ev. 19.0, 19.1, 19.2, 33.1.1**), duke u fokusuar te laboratorët e shumtë dhe modernë, që ofrojnë një ofertë akademike cilësore dhe garanci për formimin e profesionistëve të aftë për tregun e punës, gjë që konfirmohet edhe nga kontratat dhe studentët gjatë vizitës në terren. (**RVV, f. 35; Ev. 23.0, 34.6; M.3, M.4, M.5; Tur**) **[Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 Programet e studimit ofrohen në përputhje me trendet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke e bërë të mundur zhvillimin, promovimin dhe rritjen e kulturës shëndetësore, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjekësisë dhe, veçanërisht, me kërkesat e shtuara gjatë viteve të fundit për shkak të pandemisë. Bazuar te evidencat dhe vizita në terren, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm del në përfundimin se kurrikula teorike e miratuar për një proces pune dhe zhvillimi profesional në përgjithësi janë një tipar i praktikës së mirë. Stafi akademik i UAL-së është pjesë e grupeve të punës të ngritura nga MAS-i, e urdhrave të profesionistëve për përditësimin e programeve mjekësore dhe kompetencave profesionale në kuadër të përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së dhe në përputhje me direktivat për profesionet e rregulluara nga ky legjislacion, si dhe pjesë e programeve të shkëmbimit brenda ERASMUS-it (**RVV, f. 36; Ev. 26.5**). UAL-ja organizon dhe takime diskutimi me Institucione me të cilat ka marrëveshje, si DEKRA, me fokus përmirësimin e programeve dhe mësimdhënies për të lehtësuar procesin e punësimit të studentëve (**Ev. 41.1**) **[Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.5 Në fillim të çdo viti akademik, njësitë bazë të universitetit (departamentet) planifikojnë ngarkesat mësimore të personelit akademik, sipas akteve nënligjore në fuqi për ngarkesat mësimore dhe vendimet të Senatit Akademik, që u kalohet dekanëve dhe miratohet nga Senati Akademik. Ngarkesa mësimore ndahet në përputhje me kurrikulat, personelin akademik dhe kualifikimet përkatëse, për të ruajtur një shpërndarjeje optimale midis veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative, si dhe është në përputhje me përcaktimet e kategorive të diplomave dhe titujve akademikë dhe të autoriteteve qeverisëse (**RVV, f. 36; Ev. 18.1, 20.0, 20.1**) **[Kapitulli I Standardi I.5]**.
- 3.6 Programet e studimit dhe objektivat e tyre janë përcaktuar qartë, përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe vlerësohen rregullisht në përputhje me kërkesat e reja të tregut dhe në fushën e shkencës. Informacioni dhe dokumentacioni u vihen në dispozicion studentëve në formë të shtypur dhe në faqet zyrtare në internet. UAL-ja boton çdo vit akademik Katalogun Universitar (Libri Studentor) ku ka informacion të zgjeruar për të gjitha programet e studimit, organizimin e lëndëve, kreditet, semestrat kur zhvillohen dhe një

përshkrim të shkurtër të tyre me laboratorët përkatës **(Ev. 40.0)**. Gjatë pandemisë, informacioni u dha dhe në Platformën e Edukimit në Distançë UAL – LMS (<https://ual.iqe.al/>), e cila vazhdon të përdoret gjatë mësimit në auditor **(Ev. 11.7)**. Kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve jepen në rregulloren e institucionit dhe në vendimet vjetore të senatit akademik që bazohen te udhëzimet e MAS-it për pranimin dhe transferimin e studentëve, përpara fillimit të çdo viti akademik, i dërgohen MAS-it dhe publikohen në U-Albania **(RVV, f.36; Ev. 25.2, 27.0, 27.3, 27.5) [Kapitulli I Standardi I.6]**.

3.7 Programet e studimit të ciklit të parë janë bërë për t'u kuptuar lehtësisht, kanë qëllime të përcaktuara qartë dhe janë planifikuar dhe përditësuar për të përmbushur kërkesat kombëtare, duke reflektuar dhe përparimet e fundit në fushën e mjekësisë. **(RVV, f. 37; Ev. 11.3)**. Programet e ciklit të parë organizohen sipas VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe objektivat e tyre synojnë rritjen e dijes praktike, aftësive dhe kompetencave, si dhe ofrimin e dijeve bazë dhe të avancuara studentëve për të ndjekur ciklin e dytë dhe të tretë të studimit. Kurset organizohen sipas aktiviteteve të parashikuara në legjislacion dhe respektojnë raportet e formimit teorik dhe praktik duke pasur parasysh edhe faktin që karakteristikat e programeve mjekësore i bëjnë të kenë nevojë për zbatimin praktik të të gjitha procedurave. Kurrikulat janë hartuar sipas përvojës së arritur dhe vazhdojnë me programe të njëjta ose të krahasueshme të ofruara në institucione homologe, duke lehtësuar transferimin e studentëve në nivel kombëtar dhe global **(Ev. 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 27.1) [Kapitulli I Standardi I.7]**.

3.8 UAL-ja ofron një shërbim Tutorimi për të mbështetur studentët gjatë jetës universitare, për perspektivën e rritjes akademike dhe profesionale dhe aftësitë për jetën. Sipas rregullores së tutorimit, për këtë qëllim organizohen aktivitete të ndryshme mësimore për studentët nga njësitë bazë (departamentet) ku angazhohet i gjithë personeli akademik i programit të studimit **(RVV, f. 37; Ev. 11.8, 16.0, 21.2)**.

Procesi i mësimdhënies në fushën e shkencave mjekësore është kompleks për shkak të lëndëve dhe moduleve të ndryshme dhe për faktin se për secilën prej tyre nevojiten metoda të ndryshme. Stafi akademik vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe profilin e lëndëve, si dhe me zhvillimet më të fundit të fushës. UAL-ja ofron një gamë të gjerë metodash mësimdhëniejeje, duke kombinuar teorinë me praktikën, teknologjinë me mësimdhënien, shpjegimin teorik me demonstrime konkrete, si dhe aplikimin e drejtpërdrejtë të procedurave diagnostikuese dhe terapeutike gjatë praktikave klinike dhe përdorimin e mjeteve ndihmëse të teknologjisë së informacionit gjatë mësimdhënies dhe procesit mësimor **(Ev. 21.1, 31.0)**.

Procedura e rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së stafit akademik bëhet sipas një procedure të standardizuar, kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit studimor, me prioritet përfshirjen në kërkimin shkencor **(Ev. 18.0, 18.1, 18.1.1)**. Stafi akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të parë është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi **(RVV f. 40; Ev. 18.0, 18.1, 18.1.1, 19.0, 19.1, 19.2, 19.3) [Kapitulli I Standardi I.8]**.

3.9 UAL-ja ofron 6 programe studimi të ciklit të dytë (1 Master Profesional, 3 Master të Shkencave dhe 2 programe të integruara Master i Shkencave të ciklit të dytë). Këto

programe u ofrojnë studentëve njohuri të avancuara bazë, parimet e metodave shkencore dhe aftësi të veçanta për profesionin e rregulluar. Hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve të studimit e bën personeli akademik që përbëhet nga personalitete të njohura në fushën mjekësore dhe të angazhuar vazhdimisht në kërkime shkencore **(RVV, f. 40; Ev. 10.2, 11.5)**.

Këto programe janë hartuar në përputhje me kërkimin shkencor, objektivat dhe strategjinë e UAL-së, si rritja e cilësisë nëpërmjet ndërtimit të laboratorëve modernë, që janë realizuar dhe janë përdorur nga stafi dhe nga studentët për projekte kërkimore **(Ev. 02.0; Tur)**. Programet e studimit të ciklit të dytë janë të lidhura drejtpërdrejt me kërkimin shkencor, përfshirë tezën e diplomës, projekti i të cilit ndodh në universitet (në klinikën universitare dhe laboratorët e institucionit) ose në institucione të tjera në sektorin publik dhe privat, me të cilat UAL-ja ka marrëveshje **(Ev. 15.0, 15.1, 41.0)**.

Pranimi i studentëve në ciklin e dytë bëhet në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe kuotat e pranimit në çdo program studimi në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të njësisë dhe një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve mbledhet nga Zyra e Ish-Studentëve **(Ev. 25.0, 25.1, 25.2, 26.4)**. Stafi akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të parë është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi **(RVV f. 40; Ev. 18.0, 18.1, 18.1.1, 19.0, 19.1, 19.2, 19.3) [Kapitulli I Standardi I.9]**.

- 3.10 UAL-ja është pjesë e programeve të shkëmbimit të stafit dhe studentëve Erasmus +. Studentët që janë pjesë e këtyre programeve lëvizjeje, i transferojnë kreditet e tyre nga kolegjet e huaja në UAL dhe anasjelltas **(Ev. 41.2, 42.2.1)**. Njësia/moduli i ngarkesës së lëndës shprehet sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe është i organizuar në mënyrë që të ofrojë informacion të detajuar për organizimin e çdo elementi në program dhe me peshë mesatare kreditesh që studentët. të kenë mundësi për mobilitet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Diplomat e lëshuara nga UAL-ja shoqërohen me dokumentacionin përkatës sipas dispozitës ligjore në fuqi, që miratohen nga MAS-i **(RVV, f. 41; Ev. 10. 4, 10.5, 10.6)**. UAL-ja nxitet që të ketë programe mësimore në gjuhën angleze si avantazh që kontribuon për ndërkombëtarizimin e universitetit **[Kapitulli I Standardi I.10]**;
- 3.11 Ambientet e mësimdhënies në 3 godinat e disponueshme, të zhvilluara në programet e studimit në UAL, u ofrojnë studentëve formim të lartë teorik dhe praktik. Përveç laboratorëve modernë të pajisur plotësisht brenda UAL-së **(Ev. 34.6)**, ka marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e praktikave klinike me institucione të ndryshme mjekësore, si QSUT, Spitali i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Spitali Obstetrikogjinekologjik “Koço Gliozheni”, klinikat e rehabilitimit fizioterapeutik etj. Të gjitha degët kanë laboratorët e tyre, ose në Aldent, ose me MM në institucione të ndryshme shëndetësore. Duke qenë se programet e studimit po e lidhin teorinë me praktikën, studentët janë gati për tregun e punës menjëherë pas përfundimit të programit të studimit **(Ev. 14.1, 15.0, 15.1, 41.0; Tur) [Kapitulli I Standardi I.11]**.
- 3.12 Studentët e diplomuar janë të mirëpërgatitur për punësim dhe janë në gjendje të plotësojnë nevojat e sektorit shëndetësor publik dhe privat. Kurset e zhvilluara në programet e studimit janë të orientuara dukshëm drejt praktikave profesionale). Mundësitë teknike që u ofrohen

studentëve nëpërmjet pajisjeve moderne ua lehtësojnë ndjeshëm procesin mësimor, duke e bërë atë më praktik dhe më të kuptueshëm. Programet e studimit rishikohen dhe miratohen për shkak të arritjeve të reja dhe zhvillimeve me synim përgatitjen e menjëhershme të studentëve për punësim dhe programe të tjera trajnimi pas përfundimit të programeve të studimit (RVV f. 43; Ev. 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 15.0, 15.1; Tur) **[Kapitulli I Standardi I.12]**.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Universiteti “Aldent” ofron programe profesionale në përputhje me kërkesat e tregut dhe politikat dhe strategjitë e zhvillimit të shëndetësisë kombëtare dhe ndërkombëtare **[Kapitulli I Standardi I.4]**

Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UAL-ja nxitet që të ketë programe mësimore në gjuhën angleze, si avantazh që kontribuon për ndërkombëtarizimin e universitetit **[Kapitulli I Standardi I.10]**.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht**.

Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 UAL-ja siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të kurrikulës së programeve të studimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe vizionin, objektivat dhe rregulloret e UAL-së **(RVV f. 45; Ev. 01.1, 02.0, 03.0)**. Programet e studimit dhe syllabuset janë të standardizuara dhe përfshijnë kredite ECTS, objektivat e mësimi, ngarkesën e studentëve, literaturën dhe vlerësimin **(Ev. 11.4, 11.5, 11.6, 11.7)**. Në fillim të çdo viti akademik, njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit shqyrtojnë dhe propozojnë ndryshime dhe përmirësime për një zbatim më të mirë të programit të studimit dhe të procesit mësimor, propozime që u përcillen për miratim njësite kryesore përkatëse dhe Senatit Akademik **(RVV f. 45; Ev. 11.3, 11.4, 11.5, 11.6)**. Duke qenë se programet e studimit që ofrohen nga UAL-ja janë të fushës mjekësore, kanë shumë orë praktike mësimore dhe laboratorike që mbikëqyren nga staf akademik i kualifikuar në profesionet përkatëse, duke përfshirë anëtarë stafi që janë po ashtu të angazhuar në sektorin përkatës klinik dhe ua transmetojnë studentëve përvojën e tyre, duke kontribuar kështu për cilësinë e mësimdhënies **(Ev. 20.0, 20.1, 20.2; M. 3-6)**. Puna e stafit akademik koordinohet për të siguruar koherencën e programeve të studimit. Njësia bazë harton dhe planifikon ngarkesën mësimore të personelit akademik sipas kuadrit ligjor dhe rregulloreve në fuqi të UAL-së. Dokumentacioni në lidhje me programet e studimit mbahet në formë fizike dhe elektronike, përfshirë kurrikulat, syllabuset, regjistrat e lëndëve, etj. **(Ev. 11.4, 11.5, 11.6)**. Aktualisht ka 39 laboratorë të pajisur mirë për të gjitha programet e studimit në tri godinat kryesore të UAL-së, përfshirë dhe kampusin e ri, aktualisht të hapur, duke ofruar kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore për zbatimin e programeve ekzistuese në trajnimin praktik dhe profesional të studentëve, si dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme shëndetësore për zbatimin e praktikave klinike, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat **(Ev. 34.6, 41.0, 41.1)**. Stafi akademik mbikëqyr studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës në përfundim të ciklit II dhe III të studimeve sipas një modaliteti të përcaktuar për realizimin e saj, që në fund vlerësohet me notë **(Ev. 14.0) [Kapitulli I Standardi II.1]**.
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat specifike të provimeve dhe diplomimit janë të përcaktuara qartë nga rregulloret e UAL-së, që miratohen nga Senati Akademik **(Ev. 01.1, 03.0, 10.1-10.3, 14.0, 21.0, 21.2)**. Për vlerësimin përfundimtar të studentëve për një disiplinë të caktuar merren parasysh të gjitha elementet përbërëse të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, praktike, laboratorët, seminarët, projektet, kolegjiomet etj. Mënyra e vlerësimit pasqyrohet në syllabuset e çdo lënde/moduli dhe u prezantohet studentëve nga çdo pedagog në leksionin e parë por edhe nëpërmjet platformave të mësimi në distancë **(RVV, f. 46; Ev. 11.7)**. Provimet korrigjohen në fshehtësi, nëpërmjet një barkodi që i jepet çdo studenti në fillim të provimit nga sekretaria mësimore dhe zbardhet në momentin e futjes së rezultatit në sistem. Rezultatet ngarkohen në platformën elektronike të sekretarisë mësimore dhe janë të aksesueshme individualisht nga studentët. Çdo student ka të drejtë të ankohet për rezultatin në sekretari, dhe ankesa i përcillet dekanit të fakultetit përkatës **(Ev. 10.1-10.3, 14.0, 21.0, 21.2, 31.0)**.

Universiteti ofron diplomë zyrtare për çdo student që ka përmbushur detyrimet e programit të studimit. Të gjitha diplomat shoqërohen nga lista e notave dhe suplementi i diplomës në shqip dhe anglisht **(Ev. 10.4, 10.5, 10.6) [Kapitulli I Standardi II.2].**

4.3 Programet e studimit rishikohen vazhdimisht për t'iu përshtatur ndryshimeve ligjore dhe kërkesave në rritje të tregut të punës, si dhe në koherencë me zhvillimet në fushën e mjekësisë **(Ev. 11.3)**. Në fund të semestrit, çdo njësi bazë në bashkëpunim me degën mësimore harton një raport për realizimin e ngarkesës mësimore për çdo pedagog dhe çdo lëndë, që i përcillet dekanit dhe rektorit përkatës **(Ev. 20.0, 20.1, 20.2)**. Stafi i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe të rregullt nga strukturat institucionale, si NjSBC-ja, Zyra e Burimeve Njerëzore **(Ev. 18.2, 18.3)**, si dhe nga studentët, nëpërmjet pyetësorit elektronik që bëhet nga institucioni i jashtëm i kontraktuar nga UAL-ja. Të gjitha rezultatet dhe vlerësimet përdoren për të identifikuar problemet, përpunohen nga aktorët përgjegjës dhe orientohen drejt përmirësimit të cilësisë në nivel institucional **(Ev. 07.2, 07.3, 07.4, 18.2, 18.3)**. Cilësia e programeve vlerësohet edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve në këto programe studimi të mbledhura nga Zyra e ish-Studentëve dhe urdhrat përkatës të profesionistëve **(Ev. 26.2, 26.3, 26.4) [Kapitulli I Standardi II.3].**

4.4 Në përputhje me aktet dhe rregulloret e brendshme të miratuara nga UAL-ja, NjSBC-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe bën një raport vjetor të detajuar që vlerëson mësimdhënien, përfshirë dhe rezultatet e pyetësorëve të studentëve sipas IQE-së, veprimtarinë kërkimore dhe rezultatet, që u përcillen aktorëve përgjegjës **(Ev. 07.0, 07.1, 07.2)**.

Universiteti ka një gamë të gjerë laboratorësh dhe klinikash që ofrojnë kujdes për pacientët, ambiente që mbështesin mësimdhënien dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave klinike dhe ndikojnë drejtpërdrejt te rritja e cilësisë së mësimdhënies **(Ev. 24.0; Tur)**.

UAL-ja i mbështet dhe motivon anëtarët e stafit akademik që të marrin pjesë aktivisht në projekte kërkimore shkencore brenda dhe jashtë institucionit, organizon aktivitete të ndryshme e të vazhdueshme edukimi për profesionistët e shëndetësisë dhe leksione me pedagogë të huaj për stafin dhe për studentët, trajnime dhe leksione të hapura për temat pedagogjike dhe metodat e reja të mësimdhënies, veçanërisht për platformën e edukimit në distancë **(Ev. 11.9, 34.1, 35.0, 42.2) [Kapitulli I Standardi II.4].**

4.5 Sipas kuadrit ligjor aktual, njësi bazë është përgjegjëse për koordinimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Njësitë bazë mësimore-shkencore të UAL-së përfshijnë fusha të caktuara studimi dhe kërkimi. UAL-ja ka dhe Qendrën Kërkimore Farmakoterapeutike, të bazuar te Fakulteti i Shkencave Mjekësore, dhe Qendrën e Trajnimit dhe Shërbimit Klinikën dhe Qendrën e Promovimit të Shëndetit, si njësi bazë me prioritet edukimin e vazhdueshëm, shërbimet klinike, promovimin etj. Këto qendra mbështesin edhe ofrimin e programeve UAL, si Bachelor dhe Master në "Infermieri e Përgjithshme" dhe "Fizioterapi", programin e integruar Master Shkencor në "Farmaci", programin e integruar Master Shkencor në "Stomatologji" dhe specializim afatgjatë në "Stomatologji" **(RVV f. 49)**.

Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike koordinon punën kërkimore të fakultetit në lidhje me përdorimin e laboratorëve kërkimorë dhe procedurat e vlerësimit të një projekti kërkimor, sugjeron financimin e projekteve kërkimore dhe mbështet stafin për botimin në

revista, si dhe organizon konferenca të ndryshme kërkimore-shkencore. Klinika e Qendrës së Trajnimit dhe Shërbimit ka si objektiv praktikën klinike dhe u shërben studentëve dhe specialistëve për kryerjen e praktikave mësimdhënëse dhe ndihmon për kërkimin shkencor eksperimental në terren. Qendra e Promovimit të Shëndetit ndërmerri iniciativa për promovimin e shëndetit dhe kryen vlerësime dhe anketa në popullata të ndryshme për të hartuar projekte për kërkimin shkencor dhe realizimin e punimeve si tema diplomash, botime, referenca etj. **(RVV f. 49; Ev. 08.0, 34.8, 42.0).**

Ecuria e procesit mësimor nxitet nga departamentet, që motivojnë dhe mbështesin stafin për punën kërkimore dhe shkencore individuale dhe në grup, lidhur edhe me arritjet e titujve të lartë akademike, duke respektuar lirinë akademike të të gjithëve, gjë që është e ngulitur dhe Statutin e Universitetit dhe në rregulloren e Këshillit të Etikës **(Ev. 01.1, 06.0, 34.1, 41.2).**

Vlerësimi i punës shkencore bëhet në analizën vjetore të performancës nga Zyra e Burimeve Njerëzore **(Ev.18.2, 18.3).**

Institucioni ka zhvilluar programe për kërkime në nivelin e duhur për shkak të situatës së pandemisë dhe faktorëve të tjerë **[Kapitulli II Standardi I.1].**

4.6 UAL-ja reflekton në buxhetin vjetor blerjen e pajisjeve të ndryshme klinike dhe laboratorike për një bazë materiale cilësore për kërkimin shkencor dhe shërbimin klinik për pacientët në klinikën universitare **(RVV, f. 50; Ev. 34.6).** Institucioni inkurajon grupe dhe projekte të reja kërkimore. UAL-ja aplikon vazhdimisht dhe synon të marrë pjesë në projekte kërkimore të nivelit ndërkombëtar duke angazhuar stafin kërkimor akademik **(Ev. 38.0, 42.0) [Kapitulli II Standardi I.2].**

4.7 Stafi akademik efektiv i UAL-së ka qenë aktiv me botime në revista dhe pjesëmarrje në konferenca e kongrese, kombëtare dhe ndërkombëtare **(Ev. 38.0, 39.0, 42.0, 42.1, 42.3).** UAL-ja ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në disa projekte ndërkombëtare në fushën e stomatologjisë, farmacisë dhe punësimit **(Ev. 26.5, 38.0).** UAL-ja ka organizuar aktivitete shkencore ndërkombëtare, si Konferenca Ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore 2021, Kongresi Dentar në Tiranë (bashkorganizator), Simpoziumi VI dhe VII i Ortodontisë, Konferencat Mjekësore Kombëtare IV-X, Kongresi Vjetor i Kirurgjisë OMF, etj. **(Ev. 39.0, 39.1).** UAL-ja ka promovuar krijimin e revistës së saj shkencore "Albanian Journal of Biomedical Sciences AJBS" (Revista Shqiptare e Shkencave Biomjekësore) (<https://www.ajbsonline.com/>), një periodik shkencor i institucionit i botuar në anglisht që i shërben internacionalizmit të citimeve ose veprimtarisë botuese. UAL-ja ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi për aktivitete të përbashkëta shkencore, mësimdhënie, kërkime dhe shkëmbim stafi akademik, si me Universitetin e Chieti-t, Universitetin e Aquila-s, Departamentin e Odontoiatrisë në Itali, Universitetin e Ankarasë në Turqi, Universitetin Mjekësor të Plovdivit në Bullgari, Universitetin e Grazit në Austri, Kaunas në Lituani etj. **(Ev. 41.1) [Kapitulli II Standardi I.3].**

4.8 Departamentet vendosin prioritetet e tyre kërkimore në përputhje me strategjinë e kërkimit, profilin dhe infrastrukturën ekzistuese të Universitetit, si dhe prioritetet mjekësore të fushave të specializimit të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë **(RVV, f. 51, Ev. 2.0).** Duke qenë se UAL-ja është orientuar drejt programeve të studimit në fushën e mjekësisë,

ndjek një politikë mbështetëse dhe motivuese të ideve inovative në fushën e kërkimit shkencor mjekësor. Anëtarët e UAL-së janë pjesëmarrës në redaksi të ndryshme, në jurinë e mbrojtjes së titujve shkencorë apo diplomave studentore dhe janë pjesë e debatit në këto prezantime **(Ev. 14.2, 42.1)**. Komisioni i Përhershëm i Kërkimit Shkencor i universitetit e zhvillon dhe përmirëson kërkimin nëpërmjet diskutimit dhe analizës së propozimeve që lidhen me kërkimin shkencor nga njësitë bazë dhe ato kryesore **(Ev. 5.0, 5.1) [Kapitulli II Standardi I.4]**.

- 4.9 UAL-ja ofron mjediset e nevojshme materiale dhe infrastrukturore për realizimin e aplikimit profesional dhe kërkimit shkencor, duke planifikuar fondet për blerjen e pajisjeve, aparateve dhe materialeve të një cilësie të lartë në buxhetin financiar **(Ev. 28.0, 28.1; Tur)**. Gjatë zbatimit të objektivave të kërkimit institucional, UAL-ja i ka dhënë përparësi rekrutimit të personelit të kualifikuar akademik, që ka kryer veprimtari kërkimore dhe botuese në fusha të veçanta prioriteti **(Ev. 18.0, 18.1, 42.0)**. Angazhimi nga UAL-ja i stafit akademik në kërkime ndiqet sipas prioriteteve dhe grupeve të kërkimit të përcaktuara qartë, duke përbushur kështu rekomandimin nga akreditimi i mëparshëm **(Ev. 2.0) [Kapitulli II Standardi I.5]**.
- 4.10 Në planin strategjik të Universitetit shprehet qartë angazhimi për veprimtari kërkimore **(Ev. 02.0)**. UAL-ja bashkëpunon me institucione kombëtare kërkimore, si Akademia e Shkencave ose institucione që menaxhojnë dhe financojnë projekte kërkimore shkencore në Shqipëri, si AKKSHI/Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. UAL-ja ka në përbërjen e saj një grup pedagogësh të rinj që sapo e kanë përfunduar shkollën e doktoraturës. Përzgjedhja e temave të punës së tyre kërkimore u krye në bashkëpunim me institucionet paralele dhe pjesa laboratorike e punës së tyre është realizuar në laboratorët dhe klinikat e UAL-së. Njësitë bazë janë kujdesur që tema lidhur me temat e diplomave lidhet me fushat përkatëse të kërkimit **(RVV, f. 53)**. UAL-ja ka organizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve, si trajnime, seminare, leksione të hapura, dhe ka qenë partner për organizimin e konferencave kombëtare në fusha të veçanta të mbuluara nga programet tona të studimit **(Ev. 39.0, 42.3) [Kapitulli II Standardi I.6]**.
- 4.11 UAL-ja i ka mbështetur vazhdimisht iniciativat për organizimin e kongreseve, konferencave dhe seminareve ndërkombëtare dhe rajonale, ku t'i prezantohen dhe shpërndahen publikut rezultatet e kërkimit shkencor **(Ev. 39.0, 39.1, 42.2)**. Financimi i aktiviteteve kombëtare dhe rajonale nga UAL-ja tregon se ndjek politika për promovimin e kulturës kërkimore në këto nivele për të promovuar punën praktike dhe teorike të kryer në institucione dhe për të qenë në kontakt me arritjet e reja në fushën e mjekësisë, si dhe botimet në revista prestigjioze ndërkombëtare për të cilat UAL-ja mbulon tarifën e publikimit në disa raste **(RVV, f. 54; Ev. 34.1, 34.2)**. Pjesëmarrja në programet ndërkombëtare CEEPUS dhe Erasmus +, ka sjellë organizimin e trajnimeve dhe leksioneve të hapura për studentët dhe stafin akademik me financim nga BE-ja dhe mbështetje nga institucioni **(Ev. 41.2) [Kapitulli II Standardi I.7]**.
- 4.12 Anëtarët e personelit akademik u raportojnë me shkrim periodikisht dhe me hollësi shefave të departamenteve dhe qendrave të paktën një herë në vit për veprimtarinë e tyre

shkencore dhe botimet, sipas një formati të caktuar **(Ev. 42.3)**. Të gjitha këto mblidhen, dokumentohen dhe pasqyrohen në dosjen personale.

Institucioni ndjek politika për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe përpiqet të shmangë plagjiaturën duke hapur tema diskutimi në departamente ose në Komisionin e Përhershëm të Këshillit Shkencor para se të publikohen artikujt ose temat e diplomave të studentëve. Platforma Academia, sistemi i parë kundër plagjiaturës në gjuhën shqipe, u përdor si pikënisje për të identifikuar plagjiaturën në temat e diplomave studentore dhe në punën e stafit akademik.

Bëhen përpjekje për të orientuar kërkimin në dobi të programeve të studimit dhe zhvillimin e shumë fushave të studimit. Duke qenë se gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 u shfaqën disa pengesa, Institucioni bëri një plan dhe buxhet të përshtatshëm për t'i shmangur pengesat ekzistuese. **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e inkurajon UAL-në që të zhvillojë më shumë aktivitete kërkimore të lidhura dhe në përputhje me arritjet e reja shkencore dhe trendet mjekësore botërore, për shkak të pengesave gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.[Kapitulli II Standardi 1.8];**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UAL-ja inkurajohet që të zhvillojë më shumë aktivitete kërkimore të lidhura dhe në përputhje me arritjet e reja shkencore dhe trendet mjekësore botërore, për shkak të pengesave gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.[Kapitulli II Standardi 1.8];

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Vendimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre

- 5.1 Studentët pranohen në UAL në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të UAL-së. Projektet e zhvillimit afatmesëm **(Ev. 2.0)** janë zhvilluar në Universitetin “Aldent” si pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional, që përfshin politikat e pranimet për studentët e rinj. Kuotat e miratuara inspektohen dhe verifikohen çdo vit nga MAS-i, duke nxjerrë një urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës në përfundim të këtij verifikimi **(Ev. 29.1)**. Universiteti ofron informacion të gjerë nëpërmjet faqes së tij të internetit dhe fletëpalosjeve dhe reklammat për pranimin publikohen në disa televizione kombëtare dhe në median e shkruar. Universiteti ndjek politika formale për orientimin e studentëve dhe në librin e studentëve ofrohen informacione të hollësishme për pranimet dhe orientimin. **(Ev. 26.0, 26.1, 26.1.1, 40.0, 44.2)**. Njoftimet bëhen gjatë periudhës informative **(Ev. 44.1)**. Universiteti “Aldent” zgjidhet dhe nga studentë nga vendet e huaja apo shtetas që flasin shqip, kryesisht nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia etj. **(RVV, f. 57; M. 3, 4, 5)**. Aktualisht raporti staf akademik/studentë vlerësohet 1 me 12,5. **(Ev. 19.0, 19.1) [Kapitulli I Standardi III.1]**.
- 5.2 Zyra e Informacionit dhe Këshillimit për Karrierën e promovon në mënyrën e duhur informimin dhe lidhjen, si me studentët që vijnë ashtu edhe ata që dalin nga universiteti. Çdo student që shpreson të jetë ose është pjesë e Universitetit Aldent, informohet për mënyrën e organizimit të programeve, kohëzgjatjen e programeve të studimit, akreditimin e institucionit dhe programet e studimit, njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës së lëshuar nga ky institucion, brenda dhe jashtë vendit etj., informacione që publikohen në faqen e UAL-së, në rrjetet sociale, si dhe në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave FxEducation **(Ev. 26.0, 30.0, 40.0)**. Komunikimi zyrtar kryhet në mënyrë elektronike **(RVV, f. 57)**. Sekretaria mësimore ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për arritjet e nxënësve bazuar te modulet dhe ciklet akademike **[Kapitulli I Standardi III.2]**.
- 5.3 Çdo departament ka përgjegjësinë të organizojë aktivitetet e organizuara të tutorimit për studentët, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e tutorimit **(Ev. 16.0)**. Ekziston dhe kombinimi harmonik i disiplinave teorike dhe praktike sipas karakteristikave të secilit program **(Ev. 11.4, 11.5, 11.6, 11.7)**. Bazuar te legjislacioni aktual dhe rregulloret e brendshme, **(Ev. 10.2, artikulli 6)** ekziston mundësia për transferimin e programit të studimit, bazuar te procedurat ekzistuese **(Ev. 27.1, 27.4)**. Orientimi dhe këshillimi i punimeve të studentëve për të gjitha ciklet e studimit që ofron UAL-ja **(RVV, f. 58)**. Studentët e takuar gjatë vizitës në terren ishin shumë të lumtur për procesin e orientimit dhe këshillimit **(M. 3, M. 4, M. 5) [Kapitulli I Standard III.3]**.
- 5.4 Qëkurse ky institucion ka vënë në funksionim infrastrukturën e re, studentët me aftësi të kufizuara kanë aksesin e duhur, si rampa, ashensorë etj. **(Ev. 34.4; Tur)**. Për studentët me nevoja dhe statuse të veçanta, institucioni ofron lehtësi financiare që ofrohen në kontrata individuale pas dorëzimit të aplikimit në departamentin përkatës **(Ev. 34.2.1)**. UAL-ja nuk lejohet të ofrojë programe studimi me kohë të pjesshme, pasi janë profesione të rregulluara me ligj, **[Kapitulli I Standardi III.4]**.

